



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

KONFERENCA E KRYETARËVE

VENDIM

Nr. 12, datë 2.9.2019

**PËR MIRATIMIN ME MIRËKUPTIM TË PROGRAMIT TË PUNËS
DHE KALENDARIT 3 JAVOR TË PUNIMEVE TË KUVENDIT NË MBLEDHJEN
E KONFERENCËS SË KRYETARËVE, DATË 2.9.2019**

Në mbështetje të neneve 12, 26 dhe 27 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Kryetarit të Kuvendit

KONFERENCA E KRYETARËVE

VENDOSI:

I. Miratohet me mirëkuptim Programi i Punës së Kuvendit për periudhën 2 shtator – 18 tetor 2019 me propozimet e bëra dhe i përcillet Kuvendit për njoftim në seancën plenare të datës 2.9.2019.

II. Miratohet me mirëkuptim Kalendar i 3-javor i Punimeve të Kuvendit për periudhën 2 – 20 shtator 2019, me ndryshimet e propozuara në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve dhe i përcillet Kuvendit për njoftim në seancën plenare të datës 2.9.2019.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Gramoz Ruçi

